



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 181

15 nëntor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Vendim i GJK nr. 45, datë 1.11.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 848, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 205, datë 26.4.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 39, datë 15.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 00-2012-582, datë 8.3.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	7687
Vendim i GJK nr. 46, datë 11.11.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit gjyqësor nr. 00-2011-2367(376), datë 20.9.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; të vendimit nr. 52, datë 6.3.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr. 1550, datë 16.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.....	7695
Vendim i GJK nr. 47, datë 11.11.2013	Me objekt: Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2013-387 (33) të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 00-2013-387 (33) të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	7702
	Kërkesë për shpalljen e vdekjes së shtetasit Sami Muharremi.....	7706

VENDIM
Nr. 45, datë 1.11.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Elta Milori, në datën 12.9.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen nr. 27 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ardian Shkalla, përfaqësuar nga avokat Ardian Kasapi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 848, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 205, datë 26.4.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 39, datë 15.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 00-2012-582, datë 8.3.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/1, shkronjat “f” dhe “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 848, datë 21.12.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka gjykuar në mungesë dhe ka deklaruar fajtor kërkuarin Ardian Shkalla për veprën penale të “vrasjes”, në rrethana të tjera cilësuese kundër dy ose më shumë personave, të parashikuar nga neni 79/dh i Kodit Penal (KP), dhe për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, kërkuari është dënuar me burgim të përjetshëm. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim mbrojtësi i caktuar nga familjarët e kërkuarit.

2. Me vendimin nr. 205, datë 26.4.2002, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs mbrojtësi i caktuar nga familjarët e kërkuarit.

3. Me vendimin nr. 39, datë 15.1.2003, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Në vitin 2003 kërkuari është dorëzuar pranë autoriteteve shqiptare, kurse në vitin 2005 ai ka caktuar një përfaqësues për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, për kundërshtimin e procesit penal të zhvilluar në mungesë (*in absentia*).

5. Me vendimin nr. 10, datë 1.2.2005, Gjykata Kushtetuese ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, si e paraqitur jashtë afatit ligjor 2-vjeçar.



6. Pas shterimit të mjeteve të brendshme të ankimit, kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Kjo e fundit, me vendimin e datës 10.8.2011 ka pranuar ankimin e tij dhe ka arritur në përfundimin se në procesin e zhvilluar ndaj kërkuesit Ardian Shkalla ka pasur cenim të nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në dy drejtime:

- për mohimin e pajustificuar të së drejtës së aksesit në Gjykatën Kushtetuese;
- për parregullsinë e procedurave dhe dënimin e kërkuesit *in absentia*.

7. Në mbështetje të këtij vendimi të GJEDNJ-së dhe të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 1.6.2011 (në çështjen Xheraj), kërkuesi Ardian Shkalla i është drejtuar me kërkesë për rishikim Gjykatës së Lartë. Me vendimin nr. 00-2012-582, datë 8.3.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, me arsyetimin se GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje në gjykimin kushtetues dhe jo në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë dhe, për këto arsye, kërkuesi Ardian Shkalla duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me qëllim që kjo e fundit të ndreqë shkeljen e konstatuar.

8. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, si dhe të vendimeve penale të tri shkallëve të gjykimin që e kanë deklaruar atë fajtor, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur:

8.1 GJEDNJ-ja ka vlerësuar se forma më e mirë e adresimit të shkeljeve të konstatuara është gjykimi *de novo*, ose rihapja e procedurave gjyqësore nga e para, në zbatim të kërkesave për një proces të rregullt ligjor. Në një çështje të ngjashme me çështjen Shkalla, që është ajo Xheraj, Gjykata Kushtetuese bëri një interpretim të zgjeruar dhe vendosi krijimin e një mjeti ligjor për rihapjen e proceseve, që është kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë, në bazë të nenit 450/1 të KPP-së. Në kuptim dhe zbatim të këtij vendimi, kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Lartë, por kjo e fundit vlerësoi se është Gjykata Kushtetuese e cila duhet të ndreqë shkeljet.

8.2 Arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, se shkeljet janë konstatuar në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese, ndaj kjo e fundit duhet t'i ndreqë ato, është i gabuar. Duke iu referuar vendimit të GJEDNJ-së, shkeljet e konstatuara, përveç të tjerave, kanë të bëjnë me gjykimin në mungesë, çka do të thotë se kërkesa për rishikim është në kompetencën e Gjykatës së Lartë. Riparimi i shkeljeve të kësaj natyre duhet bërë pikërisht në gjykatat penale që e kanë lejuar atë.

8.3 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shkelur nenin 132/1 të Kushtetutës, duke mos respektuar fuqinë detyruese të vendimit nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me rishikimet e vendimeve në rastet e kërkuara nga GJEDNJ-ja.

II

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me kërkesën për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-582, datë 8.3.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

9. Gjykata, në interpretim të neneve 5, 116, 122 dhe 17/2 të Kushtetutës, duke vënë theksin në statusin e veçantë që ka KEDNJ-ja në rendin e brendshëm ligjor, ka njohur kompetencën ekskluzive të GJEDNJ-së në sistemin tonë juridik dhe efektin e drejtpërdrejtë të vendimeve të saj në interpretimin e standardeve kushtetuese të të drejtave të njeriut, veçanërisht atyre që i referohen së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës.

10. Vendimet e GJEDNJ-së kanë vlerën e tyre në dy aspekte, që lidhen me natyrën detyruese, që rrjedh nga nenet 1 dhe 46 të Konventës, dhe me mënyrën e zbatimit të tyre në sistemin e brendshëm. GJEDNJ-ja ka sqaruar parimet që rregullojnë zbatimin e vendimeve të saj, duke i vënë theksin zbatimit efektiv të këtyre vendimeve (*vendimi në çështjen Verein Gegen Tierfabriken Schweiz*

(VgT) kundër Zvicrës (nr. 2), datë 30.6.2009). Sipas kërkesave të nenit 46 të KEDNJ-së, një shtet palë për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se ka shkelur Konventën ose protokollet e saj, ka detyrimin që të veprojë në përputhje me vendimin e asaj Gjykate. Me fjalë të tjera, një dështim tërësor ose i pjesshëm i ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së lind përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit. Shteti në fjalë ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga Gjykata dhe të rregullojë pasojat e shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja (vendimi në çështjen *Scozzari dhe Giunta kundër Italisë*, nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII, dhe *Assanidze kundër Gjeorgjisë*, nr. 71503/01, § 198, ECHR 2004-II). Në vendimet e saj GJEDNJ-ja ka shprehur parimin e njohur të së drejtës ndërkombëtare *restitutio in integrum*, i cili është përdorur shpesh nga Komiteti i Ministrave në rezolutat e tij. Edhe pse në lidhje me mënyrën se si do të zbatojnë detyrimet e parashikuara në nenin 46 të Konventës për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, shtetet palë të Konventës gëzojnë diskrecion dhe Konventa nuk përmban dispozita që t'u imponojë palëve kontraktuese detyrimin për të parashikuar në ligjin e brendshëm rishqyrtimin apo rihapjen e procedimeve, ekzistenca e mundësive të tilla, në rrethana të veçanta, ka provuar të jetë e rëndësishme dhe, në disa raste, i vetmi mjet për të arritur *restitutio in integrum*.¹

11. Gjykata ka theksuar se gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ-së, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së, pasi respektimi i KEDNJ-së dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i kësaj Gjykate, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë Gjykatës së Lartë, për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore. Roli i një gjykate të lartë është pikërisht zgjidhja e konflikteve, shmangia e divergjencave dhe qëndrueshmëria (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket legjislacionit procedural civil, në ndryshim nga ai procedural penal, në vendin tonë janë bërë ndryshime të nevojshme, ku në nenin 494 të KPC-së është përcaktuar si një nga rastet kur pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, edhe kur Gjykata Evropiane gjen shkelje të KEDNJ-së. Në këto kushte, veç kërkesës për plotësimin e legjislacionit procedural penal, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë duhet të gjejë zgjidhjen për të vënë në vend të drejtën e shkelur të kërkuesit me qëllim të arritjes së *restitutio in integrum* (*shih vendimet nr. 22, datë 9.3.2010 (i Mbledhjes së Gjyqtarëve); nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata vëren se, në vendimin *Shkalla kundër Shqipërisë*, i datës 10.8.2011, GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si në drejtim të procesit të zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese, e cila nuk e ka pranuar ankimin si të paraqitur jashtë afatit ligjor, ashtu edhe në drejtim të procesit të zhvilluar në gjykatat e faktit, për shkak të parregullsisë lidhur me njoftimin e kërkuesit. Në lidhje me gjykimin *in absentia* GJEDNJ-ja është shprehur:

“68. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pas, të paktën, dy kërkesesh të pasuksesshme në shtëpinë e aplikantit, ky i fundit u deklarua i ikur nga gjykatat e zakonshme më 11 tetor 2001. Atij iu caktua një mbrojtës kryesisht, të cilit iu njoftuan edhe akuzat në ngarkim të aplikantit. Nuk u kontestua fakti se aplikanti nuk kishte marrë njoftim zyrtar për akuzat ose datën e gjykimit...”

71. Në rastin konkret, Gjykata vëren se apeli në Gjykatën e Apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë mbajnë nënshkrimin e aplikantit. Megjithatë, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese aplikanti ka kundërshtuar autenticitetin e nënshkrimit. Duke qenë se kërkesa kushtetuese u deklarua e papranueshme, aplikantit iu mohua mundësia për të paraqitur çështjen e tij në Gjykatën Kushtetuese për të provuar se firma nuk ishte e tij dhe, për rrjedhojë, ai nuk kishte dijeni efektivisht për procedimet kundër tij.

¹ Memorandumi shpjegues i Rekomandimit R (2000) <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=334147&Site=CM>.



72. Fakti që ankimi ishte paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga babai i aplikantit nuk nënkupton se ai kishte dijeni efektivisht për procedimet kundër tij. Gjykatat vendase nuk e morën aspak në shqyrtim këtë pyetje dhe Qeveria nuk paraqiti ndonjë provë të kundërt.

73. Përfundimisht, vetëm mungesa e aplikantit në shtëpi është e pamjaftueshme për të konsideruar se ai kishte dijeni për procedimet dhe, për rrjedhojë, ishte larguar. Për më tepër, nuk rezultoi të jenë kryer kërkime të tjera në vend ose jashtë.

74. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se nuk u provua se aplikanti ka pasur mjaftueshëm dijeni për procedimet ligjore kundër tij, që ai në mënyrë të shprehur apo të nënkuptuar ka autorizuar veprimet e familjarëve për të paraqitur ankim, ose hoqi dorë përfundimisht nga e drejta për t'u paraqitur në gjykatë duke iu fshehur qëllimisht."

13. Bazuar në vendimin e mësipërm dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi Ardian Shkalla i është drejtuar Gjykatës së Lartë, me kërkesë për rishikimin e vendimeve penale që e kanë gjykuar dhe dënuar atë në mungesë, me qëllim rregullimin e pasojave të shkeljeve të konstatuara nga GJEDNJ-ja. Pasi ka shqyrtuar kërkesën për rishikim në dhomën e këshillimit, Gjykata e Lartë, pavarësisht se ka njohur kompetencën e saj për të marrë në shqyrtim kërkesa të tilla, ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë, me arsyetimin se shkeljet e konstatuara i referohen procesit të zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese në vitin 2005 dhe jo atij të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

14. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, rikonfirmon qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ndarja midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19 datë 2.4.2012; nr. 15, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i procesit kushtetues është që të shfuqizojë ato vendime gjyqësore që kanë sjellë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe t'i japë mundësi organeve gjyqësore, të veprojnë në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së, me qëllim që të arrihet mbrojtja efektive e të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kushtet kur shkeljet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor janë konstatuar nga GJEDNJ-ja në procesin e zhvilluar në gjykatat e faktit, është kompetencë e Gjykatës së Lartë, edhe në kuptim të rolit të saj në sistemin tonë ligjor, që të marrë në shqyrtim dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e kërkuesit Ardian Shkalla për rishikimin e vendimeve penale që e kanë gjykuar dhe dënuar atë në mungesë.

15. Gjykata ka theksuar se mospranimi i kërkesës për rishikim të vendimeve nga ana e Kolegjit Penal, në kushtet kur një vendim i Gjykatës Kushtetuese ka përcaktuar Gjykatën e Lartë si organin e përshtatshëm për korrigjimin e pasojave që kanë ardhur, ngre, gjithashtu, probleme në lidhje me cenimin e fuqisë detyruese që kanë vendimet e Gjykatës. Në jurisprudencën e saj kjo Gjykatë ka vlerësuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenin 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Nëse Gjykata Kushtetuese, me vendim, përcakton se një proces gjyqësor i ka cenuar shtetasit të drejtat themelore, duke caktuar edhe detyra për gjykatat gjatë rigjykimit të çështjes konkrete, moszbatimi i këtyre detyrave automatikisht sjell një cenim të të drejtave themelore, në rastin konkret të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 5 datë 7.2.2001; nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Garantimi i zbatimit korrekt të ligjit penal, procedural dhe material nga të gjitha gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, është detyrë e Gjykatës së Lartë dhe për atë lind detyrimi që të riparojë pasojat e shkeljeve të konstatuara nga GJEDNJ-ja,

që në rastin konkret kanë ardhur si rezultat i mosnjohimit të kërkuarit për procesin penal që po zhvillohej ndaj tij dhe gjykimin e tij *in absentia*.

17. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se zbatimi i vendimit të GJEDNJ-së duhet të kryhet në mënyrën më efektive të mundshme dhe duke mos cenuar një element të rëndësishëm të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pikërisht kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa më sipër, në kushtet kur kërkesa për rishikim është mjeti efektiv për të siguruar *restitutio in integrum* të kërkuarit, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, të paraqitur nga kërkuari Ardian Shkalla, është jokushtetues dhe, si i tillë, duhet të shfuqizohet.

B. Lidhur me kërkesën për shfuqizimin e vendimeve të themelit të çështjes

19. Gjykata vëren se kërkuari Ardian Shkalla, në objektin e kërkesës ka kërkuar edhe shfuqizimin e vendimeve penale që e kanë gjykuar çështjen në fakt, edhe pse në përmbajtje të saj ka ngritur pretendime vetëm sa i takon procesin të zhvilluar nga Gjykata e Lartë, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim. I pyetur në seancë plenare lidhur me këtë pjesë të objektit të kërtimeve të tij, përfaqësuesi i kërkuarit u shpreh para Gjykatës se mjeti ligjor efektiv që ai kishte në dispozicion ishte kërkesa për rishikim dhe jo kërkesa e drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese, dhe se këto kërtime janë paraqitur për efekt të mosrënies në dekadencë të tyre.

20. Gjykata vëren se në kuptim të nenit 131, shkronja “f”, të Kushtetutës ajo vihet në lëvizje me kërkesë të individëve, pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit, për pretendimet e tyre që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Në rastin konkret, gjykimi kushtetues individual është vënë në lëvizje si pasojë e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Gjykatës së Lartë, e cila nuk ka pranuar kërkesën për rishikim të paraqitur nga kërkuari.

21. Sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një *funkcion përfundimtar*, që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apeliave (*shih vendimet nr. 10, datë 2.4.2003; nr. 9, datë 9.5.2005; nr. 10, datë 9.5.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme është një kusht, i cili bën të mundur juridiksionin kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt. Në këtë mënyrë, ky rregull përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese e gjykimin në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (parimi i subsidiaritetit) (*shih vendimin nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Çështja e shterimit të mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet përmbushur nga kërkuari, që do të thotë se individi, përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që kërkuari duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efektive për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 15, datë 18.4.2007; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 36, datë 10.11.2010; nr. 17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kërkuari duhet të provojë para Gjykatës, në aspektin e shterimit të mjeteve, se nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara, apo edhe se shqyrtimi gjyqësor nuk mund t’i ndreqë këto shkelje. Qëllimi i nenit 131/f të Kushtetutës është që të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata rithekson se, në interpretim të Kushtetutës dhe legjislationit në fuqi, si dhe të rolit të Gjykatës së Lartë në sistemin tonë ligjor, ajo



ka përcaktuar tashmë se mjeti ligjor efektiv, në dispozicion të individëve, për të rivendosur në vend të drejtat e tyre kushtetuese të cenuara gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e faktit, në rastet kur ato konstatohen si pasojë e një vendimi të GJEDNJ-së, është kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte, kërkimet e paraqitura nga kërkuesi, lidhur me vendimet gjyqësore penale që e kanë shqyrtuar çështjen në themel dhe e kanë dënuar atë, janë të tilla që i përkasin juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, në rastin konkret Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, njëzëri, të vendimit nr. 00-2012-582, datë 8.3.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

- Rrëzimin, me shumicë votash,² të kërkesës për shfuqizimin e vendimeve nr. 848, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 205, datë 26.4.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 39, datë 15.1.2003 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur më 18.9.2013.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen konkrete ndaj të njëjtin mendim me shumicën në lidhje me shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2012-582, datë 8.3.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), por çmoj se kërkesa duhej pranuar në tërësinë e saj, duke shfuqizuar të gjitha vendimet gjyqësore. Për këtë arsye e shoh me vend të shprehem me mendim paralel.

2. Shumica, në linjë me jurisprudencën e kësaj Gjykate (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), ka arritur në përfundimin se garantimi i zbatimit të ligjit penal, procedural dhe material nga të gjitha gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, është detyrë e Gjykatës së Lartë, dhe për atë lind detyrimi që të riparojë pasojat e shkeljeve të konstatuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, arsye për të cilën ka shfuqizuar vetëm vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të kërkuesit, ndërsa në lidhje me vendimet e tjera objekt kërkesë ka konstatuar se ky i fundit nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.

3. Sikurse vërehet edhe në mendimin e shumicës, kërkuesi Adrian Shkalla, pas shterimit të mjeteve të brendshme të ankimit, i është drejtuar GJEDNJ-së. Kjo e fundit, me vendimin e datës 10.8.2011, ka pranuar ankimin e tij dhe ka arritur në përfundimin se në procesin e zhvilluar ndaj tij ka pasur cenim të nenit 6/1 të KEDNJ-së, si në drejtim të procesit të zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese, e cila nuk e ka pranuar ankimin si të paraqitur jashtë afatit ligjor, ashtu edhe në drejtim të procesit të zhvilluar në fakt, për shkak të parregullsisë lidhur me njoftimin e kërkuesit dhe

² Gjyqtari Vladimir Kristo votoi pro pranimit në tërësi të kërkesës.

dënimin e tij *in absentia*. Pas këtij vendimi, Gjykata e Lartë, së cilës i është drejtuar kërkuesi, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të tij, me arsyetimin se GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje në gjykimin kushtetues dhe jo në gjykimin në Gjykatën e Lartë.

4. Edhe pse pajtohem me shumicën në vlerësimin se pas konstatimit të cenimit të nenit 6/1 të KEDNJ-së nga GJEDNJ-ja, kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë është mjeti efektiv për të siguruar *restitutio in integrum* të kërkuetit, mendoj se në rastin konkret, në ndryshim nga rasti objekt shqyrtimi në vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të kësaj Gjykate³, nuk ka asnjë pengesë që të pranohet në tërësi kërkesa në shqyrtim, duke u shfuqizuar të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna ndaj kërkuetit, dhe çështja të rikthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, aty ku fillojnë edhe shkeljet e konstatuara nga GJEDNJ-ja, për dy arsye:

- Së pari, sepse çështja hyn në juridiksionin kushtetues;
- Së dyti, sepse ankimi kushtetues, në linjë me jurisprudencën kushtetuese dhe atë të GEJDNJ-së, është mjeti efektiv për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur dhe rregullimin e pasojave të shkeljes, kur Gjykata e Lartë vendos mospranimin e kërkesës për rishikim.

A. Në lidhje me juridiksionin kushtetues

5. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 20, datë 1.6.2011, vlerësoi se kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë, në bazë të nenit 450/1 të KPP-së, është mjeti ligjor për zbatimin efektiv të vendimeve të GJEDNJ-së, me qëllim dhënien fund të shkeljes së gjetur nga kjo e fundit. Gjithsesi, në atë rast, përderisa shkelja e konstatuar nga GJEDNJ-ja ishte pushimi i çështjes së themelit, kompetencë, e cila nuk hyn në juridiksionin kushtetues, Gjykata “u kufizua” vetëm në shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që kishte vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të kërkuetit.

6. Në rastin në shqyrtim, përkundrazi, thelbi i pretendimeve të kërkuetit, sikurse u tha më lart, qëndron në parregullsinë e procesit të themelit dhe dënimin e tij *in absentia*, shkelje kjo e konstatuar nga GJEDNJ-ja. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese, në dritën edhe të zhvillimeve të jurisprudencës së GJEDNJ-së, ka riinterpretuar standardet e procedurës penale në lidhje me gjykimin në mungesë dhe sidomos në lidhje me të drejtën e mbrojtjes. Përmes këtij interpretimi, pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës, në rastin e zgjedhjes së avokatit nga familjarët, kanë ndryshuar standardet e vlerësimit të së drejtës së mbrojtjes në mungesë, e cila garantohet vetëm në kushtet e ekzistencës së vullnetit të të pandehurit, që ushtrohet nëpërmjet familjarëve.

7. Po në këtë këndvështrim, neni 33 i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet dhe se nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë. Në këtë kuptim, rregullat e ndjekura për njoftimin dhe efektiviteti i njoftimit të kërkuetit nga ana e autoriteteve, vlerësohen nga Gjykata në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson nëse autoritetet kompetente kanë përmbushur efektivisht detyrimin për njoftimin e kërkuetit, të gjykuar në mungesë, përmes zbatimit rigoroz të kërkesave procedurale për njoftimin e tij (*shih vendimet nr. 45, datë 10.10.2011; nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se “nuk u provua se aplikanti ka pasur mjaftueshëm dijeni për procedimet ligjore kundër tij, që ai në mënyrë të shprehur apo të nënkuptuar ka autorizuar veprimet e familjarëve për të paraqitur ankim, ose hoqi dorë përfundimisht nga e drejta për t’u paraqitur në gjykatë duke iu fshehur qëllimisht” (shih vendimin Shkalla kundër Shqipërisë, datë 10.8.2011, § 74). Pra, meqenëse shkelja e konstatuar nga GJEDNJ-ja hyn në shkaqet që shqyrton kjo Gjykatë në lidhje me gjykimin në mungesë të kërkuetit, vlerësoj se çështja përfshihet në juridiksionin kushtetues.

B. Gjetja e mjetit efektiv të përshtatshëm

8. Gjykata, në vështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, lidhur me interpretimin e nenit 13 të Konventës, i cili sanksionon termin “ankim efektiv”, ka theksuar se është e rëndësishme të

³ Çështja me kërkuet Arben Xheraj.



përcaktohet se çfarë mjetesh, sipas rastit, janë në dispozicion të individit dhe nëse ato i krijojnë atij mundësi reale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë efektive. Në këtë drejtim, është evidentuar se një ndër kriteret që duhet të plotësojë një ankim për të qenë efektiv është që mjeti të ofrojë mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Ajo ka përcaktuar, gjithashtu, se mjeti që të jetë efektiv, duhet të jetë i përshtatshëm, i disponueshëm dhe efikas për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 9, datë 15.3.2013; nr. 27, datë 20.6.2007; nr. 6, datë 31.3.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Nisur dhe nga sa më sipër, në lidhje me kompetencën e kësaj Gjykate për gjykimin në mungesë, si dhe në lidhje me të drejtat e konstatuara si të cenuara nga GJEDNJ-ja (shih § 6-7), çmoj se, në këtë rast, shqyrtimi në themel i çështjes nga Gjykata Kushtetuese përbën mjetin efektiv ligjor dhe të mjaftueshëm për të vënë në vend të drejtat e shkelura, të konstatuara në procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

9. Në të njëjtin drejtim vlerësoj se duhet interpretuar vendimi i lartpërmendur nr. 20, datë 1.6.2011, i kësaj Gjykate, kur thekson se qëllimi i gjykimit kushtetues, në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, është të evidentojë shkelje të mundshme të kësaj të drejte. Në kushtet kur nga GJEDNJ-ja janë konstatuar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor ndaj kërkuesit, për shkak të kompetencës ekskluzive të GJEDNJ-së në këtë drejtim, ky fakt nuk mund të vihet në diskutim. Qëllimi i procesit kushtetues në këtë rast është që të shfuqizojë ato vendime gjyqësore që kanë sjellë cenim të kësaj të drejte dhe t'i japë mundësi organeve gjyqësore, të veprojnë në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së, me qëllim që të arrihet mbrojtja efektive e të drejtave të individit.

10. Po ashtu, në bazë të nenit 132 të Kushtetutës, Gjykata ka të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton, ndërsa ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, në nenin 77 të tij parashikon që Gjykata shfuqizon aktet dhe ia dërgon për shqyrtim gjykatës përkatëse. Për rastin në shqyrtim, në interpretim të Kushtetutës, të KEDNJ-së, të jurisprudencës kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe në zbatim të parimit të zbatimit të efektshëm të vendimeve të GJEDNJ-së, në respektim të *restitutio in integrum*, jam i mendimit se Gjykata duhet të pranonte në tërësi kërkesën e paraqitur nga Adrian Shkalla dhe të shfuqizonte të gjitha vendimet objekt kërkesë.

11. Nga ana tjetër, vendimi i shumicës për shfuqizimin vetëm të vendimit të Gjykatës së Lartë bie ndesh edhe me disa parime të tjera të procesit të rregullt ligjor, të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese. Gjykata është shprehur tashmë se zbatimi i vendimit të GJEDNJ-së duhet të kryhet në mënyrën më efikase të mundshme dhe duke mos cenuar një element të rëndësishëm të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pikërisht kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Si rrjedhojë, jam i mendimit se interpretimi i shumicës nuk është as në funksion të parimit të drejtësisë efektive.

12. Nga sa më lart, përfundimisht vlerësoj se shfuqizimi vetëm i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, jo vetëm që zvarrit një proces të evidentuar tashmë nga GJEDNJ-ja si një proces i parregullt ligjor, por nga ana tjetër nuk e identifikon Gjykatën Kushtetuese si një mjet efektiv për individin. Në këto kushte, jam i mendimit se vendimi i shumicës ka më shumë vlerë formale deklarative se sa funksionale.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM
Nr. 46, datë 11.11.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari (Basha), në datën 31.1.2013, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 49/22 Akti, që i përket:

KËRKUES: Petraq Ilia

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Robert Ilia, Ilia Ilia

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit gjyqësor nr. 00-2011-2367(376), datë 20.9.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; i vendimit nr. 52, datë 6.3.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe i vendimit nr. 1550, datë 16.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 41, 42, 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenet 30, 45, 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, gjyqtarin Fatmir Hoxha; shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, pretendimet e subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Subjektet e interesuara kanë paditur kërkuarin duke kërkuar njohjen si bashkëpronarë mbi dy objekte dhe një sipërfaqe truall rreth tyre, të ndodhura në qytetin e Vlorës.

2. Pas shqyrtimit të çështjes prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2, datë 9.2.2006, kanë vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me tjetër trup gjykues.

3. Me vendimin nr. 1550, datë 16.7.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur Pranimin e kërkesëpadisë së subjekteve të interesuara/paditësit Robert dhe Ilia Ilia; Detyrimin e kërkuarit të njohë bashkëpronësinë mbi lokalitetin, mbi të gjitha shtesat e ndërtuara në të, si dhe mbi truallin prej 1100 m², me kufijtë përkatës; Detyrimin e kërkuarit të paguajë, duke filluar nga dita e ngritjes së padisë, gjysmën e të ardhurave mujore të fituara nga përdorimi i sendit në bashkëpronësi.

4. Mbi ankimin e kërkuarit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 52, datë 6.3.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1550, datë 16.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.



5. Mbi rekursin e kërkesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-2367(376), datë 20.9.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 52, datë 6.3.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

II

Pretendimet para gjykatës kushtetuese

6. **Kërkuesi** Petraq Ilia, në datën 13.4.2012 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2011-2367(376), datë 20.9.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; të vendimit nr. 52, datë 6.3.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr. 1550, datë 16.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kërkuesi pretendon se me vendimet e dhëna i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

6.1. Është shkelur parimi i arsytimit të vendimeve gjyqësore, sepse mungon baza ligjore. Gjykatat nuk kanë bërë analizën e provave dhe vendimet kanë kundërthënë të hapur dhe të fshehtë;

6.2. Është shkelur parimi i barazisë së armëve, pasi nuk u është dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe padia është pranuar mbi bazën e një prove të paligjshme, duke marrë si provë me dëshmitarë tej përmbajtjes së provës shkresore;

6.3. Është shkelur parimi i sigurisë juridike, pasi gjykatat me vendimet e tyre nuk kanë përcaktuar mënyrën se si subjektet e interesuara janë bërë pronarë. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë zbatuar konkluzionet e vendimeve njësuere të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke cenuar pritshmëritë e ligjshme.

7. **Subjektet e interesuara, Robert dhe Ilia Ilia** kanë parashtruar me shkrim si më poshtë:

7.1 Pretendimet e kërkesit se vendimet janë të paarsyetuara, pasi u mungon baza ligjore, nuk është bërë analizë e plotë e provave, ka kundërthënë të hapur dhe të fshehtë në vendim, janë të pabazuara. Kërkuesi, me dashje, nuk përmend dispozitat ligjore të Kodit Civil dhe të Kodit të Procedurës Civile ku bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes. Gjykatat në vendime kanë arsytuar duke analizuar të gjitha pretendimet e palëve, mbështetur në provat e paraqitura gjatë gjykimit. Gjithashtu, në arsyetimin e vendimeve nuk ka asnjë kundërthënë. Marrja dhe vlerësimi i provave është bërë në zbatim të neneve 232, 233 të Kodit të Procedurës Civile.

7.2 I pabazuar është dhe pretendimi se është cenuar parimi i barazisë së armëve. Pretendimet e kërkesit janë të lidhura me kuptimin dhe interpretimin e ligjit në proceset gjyqësore, e, për rrjedhojë, nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

7.3 Gjykatat, gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjes, kanë zbatuar dhe interpretuar dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi dhe interpretimi nuk cenon parimin e sigurisë juridike, përkundrazi, përbën garanci për dhënien e drejtësisë.

III

Vlerësimi i gjykatës kushtetuese

8. Në analizën e pretendimeve të kërkesit, Gjykata paraprakisht thekson se ajo i vlerëson këto pretendime në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që u ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese.

A. Lidhur me pretendimin e cenimit të parimit të arsytimit të vendimeve gjyqësore

9. Kërkuesi pretendon se në vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mungon baza ligjore e padisë, nuk janë analizuar provat, si dhe ka kundërthënë të hapura dhe të fshehta.

10. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42, 142, pika 1 e Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet

vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion, të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin e arsyetimit të vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Neni 310, pika 1, i Kodit të Procedurës Civile parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve.

15. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se në vendimet objekt shqyrtimi janë pasqyruar palët ndërgjyqëse, baza e plotë ligjore, si dhe pretendimet e palëve. Rrjedha logjike e përdorur në vendim rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe argumentet e pjesës hyrëse janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Gjykata e Apelit Vlorë i ka cituar provat e administruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe i ka analizuar dhe vlerësuar ato. Edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka bërë një analizë të hollësishme të të gjitha pretendimeve të kërkuarit. Kolegji ka arritur në përfundimin se vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta janë të bazuara në ligj, duke vendosur lënien në fuqi të tyre.

16. Në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm kanë përmbajtje logjike brenda tyre dhe nuk paraqesin asnjë kundërthënie të hapur apo të fshehtë. Gjykatat janë të qarta në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe lidhur me faktet që janë konsideruar të provuara, duke zbatuar dhe detyrat e lëna nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në rigjykimin e çështjes.



17. Sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të arsytimit të vendimeve gjyqësore, është i pabazuar.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve

18. Kërkuesi pretendon se gjykatat në vendimet e tyre, nuk i kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të paraqitura lidhur me përcaktimin qartë të bazës ligjore dhe të mënyrës së fitimit të pronësisë nga subjektet e interesuara, duke cenuar parimin e barazisë së armëve. Gjithashtu, është marrë si e vlefshme një provë që ndalohej nga ligji, provë me dëshmitarë tej përmbajtjes së provës shkresore.

19. Gjykata ka tashmë një praktikë të konsoliduar, sipas së cilës parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që në çështjet civile secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve, të cilat nuk e vendosin në disavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimin nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt, në kuptimin kushtetues. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë në kohë të mjaftueshme palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar ata padrejtësisht nga gjykimi (*shih vendimin nr. 42, datë 29.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata konstaton se në çështjen në shqyrtim standardet kushtetuese lidhur me barazinë e armëve nuk janë cenuar nga gjykatat e zakonshme.

21. Në thelb, pretendimet e kërkuesit lidhen me interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e provave nga gjykatat e zakonshme, konkretisht me zbatimin e dispozitave të Kodit Civil për mënyrën e fitimit të pronësisë dhe vlerësimin të provave.

22. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë, pasi kanë shqyrtuar të gjitha provat e paraqitura, midis tyre aktet shkresore që provonin bashkëpronësinë midis kërkuesit dhe subjekteve të interesuara, si dhe prova me dëshmitarë, i kanë vlerësuar të drejta pretendimet e subjekteve të interesuara. Gjykatat kanë arsyetuar dhe vlerësuar marrjen e provave me dëshmitarë në zbatim të neneve 232 dhe 233 të Kodit të Procedurës Civile⁴.

23. Gjykata Kushtetuese ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve lidhet me interpretimin e zbatimit të ligjit, si dhe me vlerësimin e provave, e cila është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

25. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit nuk hyn në juridiksionin kushtetues e, si i tillë, nuk mund të merret në shqyrtim prej kësaj gjykate.

⁴ Neni 232 i Kodit të Procedurës Civile:

Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Gjithashtu, nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës ose shuarja, me anë të pagimit ose të faljes së detyrimeve në të holla, që rrjedhin nga një kontratë e bërë me dokument.

Neni 233 i Kodit të Procedurës Civile përcakton rastet e lejimit të provës me dëshmitarë.

C. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

26. Kërkuesi pretendon se gjykatat, duke vendosur pranimin e padisë së paraqitur nga subjektet e interesuara, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi u kanë njohur të drejtën e pronësisë personave që nuk kanë qenë palë në veprime juridike. Mënyrat e fitimit të së drejtës së pronësisë, si një e drejtë themelore, janë të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë dhe në Kodin Civil.

27. Gjykata rithekson se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Jurisprudenca e kësaj Gjykate referon te ky parim konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar dhe të pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike është një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës dhe përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore (*shih vendimin nr. 33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në çështjen konkrete, objekt gjykimi ka qenë njohja e së drejtës së bashkëpronësisë në pasurinë lokal dhe truall. Subjektet e interesuara kanë pretenduar se kanë kontribuar bashkërisht në blerjen, ristrukturimin dhe ndërtimin e kësaj pasurie, pavarësisht faktit se në kontratën e blerjes është shënuar vetëm emri i kërkuesit (njëri prej vëllezërve). Kontributet kanë ardhur dhe si rezultat i krijimit të shoqërisë “Ilia”, në emër të së cilës është lëshuar dhe leja e ndërtimit për godinën. Qëllimi i subjekteve të interesuara dhe kërkuesit ka qenë krijimi i një pasurie të përbashkët. Në mungesë të një marrëveshjeje paraprake me shkrim mes tyre, ku do të shprehej qartë vullneti i vëllezërve, ata kanë rënë dakord që të shënohet vetëm emri i njërit prej tyre në kontratë. Ky moment ka përcaktuar natyrën e marrëdhënies juridike të krijuar mes tyre dhe natyrën juridike të mosmarrëveshjes së lindur më vonë. Ky proces konsiderohet njohje pronësie dhe është i detyrueshëm për palët e përfshira në gjykim.

29. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se qëndrimi i mbajtur nga gjykatat e zakonshme ka cenuar pritshmërinë e tij të ligjshme lidhur me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes gjyqësore. Sipas tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka pasur parasysh vendimet njësuere të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimet nr. 1, datë 6.1.2009 dhe nr. 9, datë 9.3.2006. Vendimet njësuere kanë mbajtur qëndrim për vlefshmërinë e veprimit juridik, kushtet për të qenë i tillë, formën dhe përputhjen e vullnetit, për cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve, për bazën juridike të padisë dhe shkakun ligjor të saj.

30. Gjykata çmon se dhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret lidhet me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, dhe, si i tillë, edhe ky pretendim nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

31. Në përfundim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Petraq Ilia, për shfuqizimin e vendimeve objekt shqyrtimi, është e pabazuar dhe duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.



Vendosur më 19.3.2013

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi⁵, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

Anëtare kundër: Vitore Tusha

MENDIM PARALEL

Në çështjen konkrete pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, por e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim paralel, për të paraqitur arsye të ndryshme nga shumica për këtë qëndrim.

Shumica, në këtë çështje, për sa i përket pretendimit të kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka konstatuar se “në vendimet objekt shqyrtimi janë pasqyruar palët ndërgjyqëse, baza e plotë ligjore, si dhe pretendimet e palëve. Rrjedha logjike e përdorur në vendim rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe argumentet e pjesës hyrëse janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Gjykata e Apelit Vlorë i ka cituar provat e administruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe i ka analizuar dhe vlerësuar ato. Edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka bërë një analizë të hollësishme të të gjitha pretendimeve të kërkuarit” (prg. 15 i vendimit). Më tej, shumica ka vlerësuar se “vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm kanë përmbajtje logjike brenda tyre dhe nuk paraqesin asnjë kundërthënie të hapur apo të fshehtë. Gjykatat janë të qarta në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe lidhur me faktet që janë konsideruar të provuara...” (prg. 16 i vendimit). Si përfundim, shumica ka konkluduar se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, është i pabazuar (prg. 17 i vendimit).

Gjykoj se, në vendimet e gjykatave objekt kontrolli, interpretimi dhe zbatimi i ligjit nuk ndjekin një rrjedhë logjike, të qartë dhe të kuptueshme. Por, këto të meta në arsyetim nuk janë aq serioze sa t’i bëjnë të cenueshme vendimet në fjalë, në aspektin kushtetues. Vlerësimi i tyre i përket juridiksionit të zakonshëm gjyqësor dhe, në shkallë të fundit, Gjykatës së Lartë.

Ashtu siç ka pohuar edhe shumica, Gjykata e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve ligjore të përcaktuara në jurisprudencën e saj, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Në aspektin e kontrollit kushtetues, nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Verifikimi që bën Gjykata në këto raste është një proces vlerësimi, nëpërmjet të cilit analizohet nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër. Ky vlerësim nuk bëhet vetëm në aspektin formal, pra nëse elementet e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë pasqyruar grafikisht në vendim, por edhe në aspektin substancial, se si gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë integruar këto elemente në drejtim të interpretimit të ligjit, analizës së provave dhe zgjidhjes së çështjes së themelit. Shumica, në rastin konkret, është mbështetur në një qasje formale dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit në aspektin substancial.

Në vendimet gjyqësore, objekt kontrolli, ekzistenca e marrëdhënies së bashkëpronësisë, të parashikuar nga neni 199 të Kodit Civil, i cili referohet si bazë ligjore, mbështetet në marrëveshjen verbale ndërmjet palëve, të cilën e kanë provuar nëpërmjet dëshmitarëve dhe dokumenteve të tjera, për shkak të marrëdhënies së posaçme ndërmjet palëve, duke u bazuar në nenin 233 të Kodit të Procedurës Civile. Arsyetimi i gjykatave do të kishte një rrjedhë logjike nëse: fillimisht do të bëhej

⁵ Gjyqtari S. Berberi votoi pro rrëzimit të kërkesës, por me argumente të tjera.

një cilësim i qartë i veprimit juridik/marrëdhënies juridike; do të sqarohet më pas se çfarë kërkon ligji për vlefshmërinë/provueshmërinë e kësaj marrëdhënieje juridike; dhe, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, do të interpretohet dhe vlerësohet në mënyrë të qartë neni 233 i KPC-së, kushtet që kërkojnë për zbatimin e këtij neni dhe nëse këto kushte përmbusheshin në rastin konkret.

Siç u shpreh dhe më lart, të metat që konstatohen në interpretimin dhe zbatimin e ligjit material dhe procedural civil janë çështje të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor dhe, veçanërisht, të kontrollit rishikues të Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit, në disa raste të ngjashme, me bazë ligjore nenin 199 të Kodit Civil, e gjendur përpara marrëveshjes joshkresore të palëve për krijimin e bashkëpronësisë, ka theksuar rëndësinë e provës shkresore në marrëdhëniet e pronësisë dhe detyrimin e gjykatave për të argumentuar në vendim pamundësinë e palëve për marrjen e provës shkresore (*shih vendimin nr. 00-2007-1441, datë 5.11.2007 të Gjykatës së Lartë*). Edhe në vendimin nr. 00-2007-1583, datë 22.11.2007, Gjykata e Lartë është shprehur për fitimin e bashkëpronësisë sipas mënyrave që njeh ligji, duke nënvizuar detyrimin që kishte gjykata më e ulët për të evidentuar qartë në arsyetim se nuk përbën mënyrë të fitimit të pronësisë kontributi i një personi në shlyerjen e kredisë të marrë nga pronari i sendit.

Si përfundim, bazuar në sa më sipër, vlerësoj se të metat e evidentuara në arsyetimin e vendimeve, objekt shqyrtimi, nuk janë të tilla sa t'i bëjnë këto vendime të cenueshme, në aspektin kushtetues.

Anëtar: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Ndaj mendim të kundërt me shumicën, pasi vlerësoj se vendimet, objekt shqyrtimi, kanë cenuar të drejtën themelore të kërkuarit për një gjykim të rregullt ligjor, në drejtim të mosrespektimit të standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

Kërkuari ka pretenduar se në vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mungon baza ligjore e padisë. Këtë pretendim shumica e ka analizuar nën dritën e së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42, 142, pika 1 e Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Standardi, të cilit i referohet edhe shumica, evidenton se “Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion, të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Ndryshe nga arsyetimi i shumicës, mendoj se standardet e mësipërme kushtetuese në lidhje me arsyetimin e vendimit gjyqësor, nuk gjejnë zbatim në çështjen konkrete objekt gjykimi, për arsye se edhe në rast se do të prezumim se vendimi objekt shqyrtimi plotëson kërkesat për “pasqyrimin e palëve ndërgjyqëse, të bazës së plotë ligjore, si dhe të pretendimeve të palëve...” (paragrafi 15), evidentimi i këtyre elementeve formale nuk përbën argument të mjaftueshëm për të vlerësuar se baza



ligjore e pasqyruar në vendim përbën bazën “mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes”. Në rastin konkret, edhe pse vendimi i kundërshtuar pasqyron si bazë ligjore të mosmarrëveshjes nenin 199 të Kodit Civil, ky i fundit nuk parashikon asnjë nga mënyrat e fitimit të pronësisë apo të bashkëpronësisë, pasi neni në fjalë përcakton vetëm kuptimin e bashkëpronësisë. Edhe nenet 232 dhe 233, të cilave u referohet gjykata e zakonshme, janë norma procedurale që rregullojnë kufijtë e lejimit të provës me dëshmitarë. Në çështje, të cilat kanë për objekt shqyrtimi mënyrën e fitimit të pronësisë (apo bashkëpronësisë), faktet formohen sipas rregullave procedurale në varësi të kërkesave të ligjit material. Në rastin konkret, referimi nga gjykatat në rregullat procedurale të parashikuara nga nenet e mësipërme, nuk është e mjaftueshme për të provuar se kërkuesi gëzonte titullin e pronësisë, apo se e kishte fituar atë sipas një prej mënyrave të fitimit të pronësisë.

Nën dritën e vlerësimeve të mësipërme, mendoj se edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e sigurisë juridike, duhet parë në dritën e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Shumica, duke e renditur si pretendim më vete, arsyeton se: “pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret lidhet me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, dhe, si i tillë, edhe ky pretendim nuk hyn në juridiksionin kushtetues”. Ndonëse shumica e vlerëson pretendimin si çështje të interpretimit të ligjit apo zbatimit të tij, në fakt, vendimi gjyqësor i kundërshtuar nuk përmban asnjë analizë në lidhje me vlefshmërinë e kontratave, si akte noteriale të regjistruara në hipotekë, përmbajtja e të cilave mund të ndryshohet duke u goditur vetëm për falsitet, ose për ekzistencën e ndonjë prej rasteve të pavlefshmërisë. Në mungesë të analizës së këtyre fakteve, gjykata e zakonshme ka konkluduar në mënyrë të gabuar mbi ekzistencën e bashkëpronësisë, tej përmbajtjes së kontratave.

Në përfundim të analizës së mësipërme, nisur nga vlerësimi mbi bazueshmërinë e pretendimeve të kërkuesit, kërkesa duhet të ishte pranuar, me qëllim rivendosjen e të drejtave të cenuara.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 47, datë 11.11.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 19.9.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 25 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Afërdita Papamihali

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2013-387 (33) të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 00-2013-387 (33) të Kolegjit Penal të Gjykatës së

Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; vendimi nr. 47, datë 26.7.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 300, datë 10.11.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka vendosur:

“Deklarimin fajtores të së pandehurës Afërdita Papamihali, për kryerjen e veprës penale “shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e saj me 2 vjet e 6 muaj burgim dhe 500 000 lekë gjobë... Në bazë të nenit 35/2 të KP-së, heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurën Afërdita Papamihali, për një periudhë prej 3 vitesh”.

2. Me vendimin nr. 123, datë 13.9.2010, Gjykata e Apelit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 300, datë 10.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në lidhje me të pandehurit Sotiraj Janora, Alfred Mamani, Leonard Mustafaraj dhe Petrit Maksuti. Prishjen e këtij vendimi në lidhje me të pandehurit Gaqe Meçi, Afërdita Papamihali dhe Admir Shehaj, dhe pushimin e çështjes ndaj tyre, pasi nuk vërtetohen elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar, atë të parashikuar nga neni 248 i KP-së.”* Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjyqësor Gjirokastrë.

3. Me vendimin nr. 00-2013-387 (33), datë 31.1.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 123, datë 13.9.2010 të Gjykatës së Apelit Gjyqësor Gjirokastrë për të gjykuar Gaqe Meçi, Afërdita Papamihali dhe Admir Shehaj, duke lënë në fuqi për këta të gjykuar vendimin nr. 300, datë 10.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë...”*

II

4. **Kërkuesja Afërdita Papamihali** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për këto shkaqe:

4.1 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se ndaj kërkueses janë aplikuar dy dënime kryesore dhe, në kuptim të vendimit nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese, ka pranuar paligjshmërinë dhe antikushtetutshmërinë e vendimit të gjykatës së faktit dhe ka ndryshuar vetë statusin e dënimit me gjobë, nga dënim kryesor në dënim plotësues. Në këtë drejtim, ky Kolegj, në kundërshtim me pjesën arsyetuese të vendimit të tij, në pjesën urdhëruese ka lënë në fuqi një vendim antikushtetues, duke e legjitimuar atë.

4.2 Gjykata e Lartë ka tejkalluar kompetencat e saj ligjore, sepse me këtë ndryshim ajo, efektivisht, ka realizuar politikën e dënimit, duke preferuar dënimin me burgim si dënim kryesor, përkundrajt atij me gjobë. Përcaktimi i dënimit kryesor për kërkuesen mund të jetë vetëm rezultat i çmimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe të të gjykuarit, çka është atribut i gjykatës së faktit dhe nuk hyn në kontrollin ligjor të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë duhej të kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatën e faktit për të konkluduar lidhur me dënimin kryesor për kërkuesen.

5. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në parashtrimet drejtuar Gjykatës Kushtetuese, paraqet këto prapësime:



5.1 Në lidhje me pretendimin e parë, pjesa urdhëruese e vendimit të dënimit nuk përmend se të cilës natyrë janë dënimet e dhëna për kërkuesen, kurse pjesa argumentuese e tij është ndryshuar nga Gjykata e Lartë, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por ai nuk ka sjellë pasoja në pjesën urdhëruese. Në këtë mënyrë, për kërkuesen nuk është e rëndësishme se si do të quhet dënimi me gjobë (kryesor detyruës apo plotësues) në kuptim të nenit 34/5 të KP-së, por a do të duhet ta vuajë atë, pra a duhet të paguajë gjobën.

5.2 Në lidhje me pretendimin e dytë, ndryshimet që iu bënë KP-së në vitin 2013, mes të cilave është dhe neni 248 për të cilin është deklaruar fajtores kërkuesja, kanë ecur në linjë me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë aspekt, fakti që Gjykata e Lartë ka zgjedhur dënimin me burg si dënim kryesor është një rrjedhim logjik, i natyrshëm dhe ligjor dhe brenda kuadrit të saj të shqyrtimit dhe vendimmarrjes.

III

Lidhur me kërkesën për pezullim

6. Mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese mori në shqyrtim, përpara seancës plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 00-2013-387 (33), datë 31.1.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me vendimin e datës 20.6.2013, mbledhja e gjyqtarëve vendosi rrezimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk ndodhej para kushteve të parashikuara në këtë dispozitë.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

7. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) thekson se ajo i vlerëson pretendimet e kërkueses në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, konkretisht, në aspektin e detyrimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për respektimin e këtyre standardeve.

A. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

8. Kërkuesja pretendon se Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, duke caktuar për të si dënim kryesor atë me burgim, përkundrajt atij me gjobë, ndërkohë që caktimi i dënimit kryesor mund të jetë vetëm rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe të të gjykuarit, çka është atribut i gjykatës së faktit. Në këtë kuptim, kërkuesja pretendon se Gjykata e Lartë duhej të kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatën e faktit për të konkluduar lidhur me dënimin kryesor.

9. Gjykimi nga një “gjykatë e caktuar me ligj”, është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se termi “gjykatë” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë, përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 16, datë 27.3.2012; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket shprehjes “e caktuar me ligj”, kjo përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Gjykata ka vlerësuar se, nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të

pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është “e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është, ndër të tjera, parakusht për të mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar. Shqyrtimi i një çështjeje nga një gjykatë jo kompetente nuk përbën në çdo rast vetëm një shkelje procedurale, por ka të bëjë edhe me respektimin e të drejtës kushtetuese për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Marrja nga një gjykatë e kompetencës që i takon me ligj një gjykatë tjetër, mund të bëhet vetëm nëse e lejon ligji dhe vetëm nga gjykatat që ai cakton (*shih vendimin nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë sanksionon dy lloje dënimesh, dënimet kryesore dhe ato plotësuese. Dënimet kryesore janë të parashikuara në nenin 29 të KP-së dhe, sipas kësaj dispozite, në llojin e dënimeve kryesore, të cilat mund të jepen nga gjykatat e zakonshme për personat që kanë kryer krime, hyjnë dënimi me burgim të përjetshëm, dënimi me burgim dhe ai me gjobë. Ndërsa, për personat që kanë kryer kundërvajtje, dënimet kryesore janë dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë. Dënimi me burgim parashikohet nga neni 32 i KP-së, ndërsa dënimi me gjobë nga neni 34 i KP-së. Mes të tjerash, në paragrafin e pestë të tij, neni 34 parashikon dënimin me gjobë, krahas atij me burgim, “*për personat që kryejnë krime për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material.*” Përveç dënimeve kryesore, gjykatat, kur e çmojnë të arsyeshme, mund të caktojnë edhe një ose më shumë dënime plotësuese, të parashikuara nga neni 30 i KP-së, në lidhje dhe me nenet 35-43 të tij.

12. Me vendimin nr. 47, datë 26.7.2012, Gjykata vendosi shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, edhe të nenit 29, paragrafi i fundit, të KP-së, duke arsyetuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë shqyrtimit konkret të veprave penale, nuk mund të aplikojnë njëkohësisht dy dënime kryesore, në rastet kur këto dënime janë të parashikuara në dispozitat e pjesës së posaçme të KP-së. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë të gjitha mundësitë, me parashikimet aktuale të KP-së, të japin dënimin me burgim si dënim kryesor, në të gjitha rastet e përcaktimit të dy dënimeve kryesore në dispozitat e pjesës së posaçme të KP-së, si dhe ta ashpërsojnë atë me dënimin me gjobë kur plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, të KP-së.

13. Gjykata ka vlerësuar se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimin për autorët e veprave penale. Sipas nenit 47 të KP-së, në caktimin e dënimin gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Po ashtu, gjykatat e zakonshme, në bazë të sanksionimit, në Pjesën e Përgjithshme të Kodit Penal, të dënimeve plotësuese, si dhe në bazë të parashikimit të nenit 34, paragrafi i pestë, të KP-së, kanë mundësinë e ashpërsimit të dënimin kryesor me një ose disa dënime plotësuese ndaj atyre autorëve të veprave penale rrezikshmëria e të cilëve është e lartë, ose të përcaktojnë edhe një masë ndëshkimi me gjobë ndaj autorëve të atyre veprave penale që kryejnë krime për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, duke realizuar, në këtë mënyrë, qëllimin e ligjvënësit në luftën kundër kriminalitetit nëpërmjet ashpërsimit të masave ndëshkuese (*shih vendimin nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, rezulton se ajo është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, pas shpalljes së vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në



këtë vendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se dënimi me gjobë në vlerën prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë për kërkuesen, i përgjigjet dënimit plotësues, pasi dënimi me gjobë nuk mund të jepet si dënim kryesor së bashku me dënimin me burgim. Si përfundim, Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi për kërkuesen si dënimin me burgim (si dënim kryesor), ashtu edhe atë me gjobë (si dënim plotësues).

15. Në lidhje me aplikimin e dënimit me gjobë krahas atij me burgim, kërkohet plotësimi i kriterëve të parashikuara në nenin 34/5 të KP-së, pra kryerja e veprës penale për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material. Në rastin konkret, rezulton se kërkuesja Afërdita Papamihali është dënuar për kryerjen e veprës penale “shpërdorim i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, dhe, në bazë të nenit 35/2 të KP-së, ndaj saj është dhënë si dënim plotësues “heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike”. Nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që e ka dënuar kërkuesen, nuk rezulton që elementet që kërkon zbatimi i nenit 34/5 të KP-së të jenë analizuar dhe provuar në atë gjykim, duke qenë se dënimi me gjobë është aplikuar nga gjykata si pasojë e zbatimit të dispozitës ligjore në fuqi në momentin e gjyqimit të kësaj çështjeje.

16. Vlerësimi i tërësisë së faktit penal, në lidhje me të gjitha elementet dhe rrethanat që e përbëjnë atë, me qëllim të individualizimit të shkallës së përgjegjësisë të të pandehurit dhe përshtatshmërisë së dënimit, hyn në fushën e diskrecionalitetit të gjyqtarit të faktit, kurse Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural dhe kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Në këtë kuptim, në rastin konkret, Gjykata e Lartë, duke dhënë për kërkuesen dënimin me gjobë krahas atij me burgim, ndërkohë që gjykata e shkallës së parë nuk ka hetuar nëse plotësoheshin kushtet e nenit 34/5 të KP-së, ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, duke cenuar parimin e gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-387 (33), datë 31.1.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë Gjykatë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur më 19.9.2013

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtare kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

KËRKESË

Shtetasi Hysni Muharremi kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen e vdekjes së shtetasit Sami Muharremi, në datën 7.5.1998, në fshatin Zall-Herr të komunës Zall-Herr.

KËRKUES

Hysni Muharremi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 24 lekë